



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 198 Prot

Datë 23 / 11 /2020

VENDIM

Nr. 46, Datë 23.11.2021

PËR MIRATIMIN E MODELEVE TË PROCESVERBALEVE DHE TABELAVE PËR SHPALLJEN E REZULTATEVE PËR ZGJEDHJET NË KOMISIONIN E PËRHERSHËM PËR DHËNIEN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË NIVEL NJËSIE KRYESORE, NË TË 3 (TRI) NJËSITË NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të Nenit 32, të Rregullores së Zgjedhjeve miratuar me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Komisioni Institucional Zgjedhor, pasi përgatiti modelet e Procesverbaleve dhe Tabelat e Rezultateve që do të përdoren për zgjedhjet në Komisionin e përhershëm për dhënie të Gradës Shkencore “Doktor” në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, në mbledhjen e datës 23.11.2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë modelet e Procesverbaleve dhe Tabelat e Rezultateve që do të përdoren për zgjedhjen e anëtarëve në Komisionin e përhershëm në Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike,

Modelet e Procesverbaleve si më poshtë:

- Procesverbal “Për pajisjen e KZF nga KIZ me materiale zgjedhore”
- Procesverbal “Për vulosjen e kutive të votimit”
- Procesverbal “Vendim për hapjen e qendrës së votimit”
- Procesverbal “Për pezullimin e votimit të zgjedhjeve”
- Procesverbal “Për rifillimin e votimit të zgjedhjeve”
- Procesverbal “Për mbylljen e votimit të zgjedhjeve”
- Procesverbal “Vendim për fillimin e numërimit të votave nga KZF”
- Procesverbal “Për dorëzimin e materialeve zgjedhore nga KZF në KIZ”

Modelet e Tabelave të Rezultateve si më poshtë:

- Tabela e Rezultateve për anëtarë të Komisionit të përhershëm në Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Mjekësisë Dentare dhe Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike,
2. T'i bashkëlidhë këtij vendimi të gjitha modelet e Procesverbaleve dhe Tabelave të Rezultateve për zgjedhjet e anëtarëve në komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit.

KRYETAR

SILVANA BALA

